



## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

### Neni 1

Palët nënshkruese të këtij memorandumi:

1. Kolegji BIZNESI-Prishtinë, rruga "Motrat Qiriazi" nr 29 të cilën e përfaqëson Dr. Shyqeri Kabashi -Dekan, dhe
2. Heinze SH.P.K., Adresa: "Haxhi Hoti nr.173" Rogovë R. e Kosovës, me NRB 811127431.

### Neni 2

Qëllimi i këtij Memorandumi

Ky Memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve dhe afatet themelore, në bazë të të cilave Kolegji BIZNESI- Prishtinë dhe Heinze SH.P.K.-Rogovë, pajtohen për bashkëpunim.

### Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Heinze SH.P.K.-Rogovë do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi Kolegjin Biznesi, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikën e këtij institucionit.
2. Kolegji Biznesi do të mbështesë në vazhdimësi Heinze SH.P.K.-Rogovë në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomisë** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit.
3. Kolegji Biznesi do të mbështesë, Heinze SH.P.K.-Rogovë me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: Emergjencave, Ekonomisë dhe Jurisprudencës-sipas nevojave që paraqet Heinze SH.P.K.

#### Neni 4

#### Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Afati i këtij memorandumit është në kohë të pacaktuar. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

#### Neni 5

#### Kopjet e Memorandumit

Memorandumi është punuar në katër kopje origjinale, nga dy kopje për secilën palë.


#### Neni 6

#### Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

#### PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji BIZNESI Prishtinë

  
/Prof. Dr. Shyqeri Kabashi/  
D e k a n



Heinze SH.P.K.

  
/Fitim Hoti/  
Drejtor



Nënshkruar në Prishtinë, me datë 04/12/2020